



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI KOMUNËS NË MALISHEVË

PRANUAR MË

ACCEPTED ON

PRIMLJENDI

Nr. No. Bt.

03.12.2018

02/501

Komisioni Komunal për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale

Nr. 02/

Dt. 03.12.2018

Në bazë të nenit 5 të Ligjit nr. 04/L-144 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 7 të Rregullores QRK nr. 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës Nr.02/140 për Dhënie në Shfrytëzim Afatshkurtër të Hapsirave Publike për Reklamë:

Komisioni Vlerësues për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale, më datë 03.12.2018, shpall:

**NJOFTIM PËR ANKAND PUBLIK  
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR, TË HAPSIRAVE PUBLIKE PËR  
VENDOSJEN E REKALAMEVE NË QYTETIN E MALISHEVËS**

**EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)**

- Komuna Malishevës – Komisioni Vlerësues për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale;
- Adresa Rr."Gjergj Kastrioti – Skenderbeu", p.nr;
- Kodi Postar Malishevë 24 000.

**LËNDA E ANKANDIT**

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Malishevës, në bazë të Vendimit Nr.02/244, datë 02.07.2018 ka përcaktuar si qëllim dhënie shfrytëzim afatshkurtër të hapësirave publike për vendosjen e reklamave në qytetin e Malishevës, personave juridik dhe personave fizik në afat deri me **prej 2 (dy) viteve** nga dita e nënshkrimit të kontratës, përmes ankandit publik, procedura përmes ofertave të mbyllura.

**Dhënia në shfrytëzim afatshkurtër ( afati sipas Vendimit Nr.02/244, datë 02.07.2018 ) e pronës komunale si vijon:**

1. Hapsirat publike për vendosjen e reklamave ndodhen në pjesën e urbane të qytetit të Malishevës, në sipërfaqe të përgjithshme prej **288 m<sup>2</sup>**;
2. Gjithsejtë hapësirë (vende) për reklamë janë 9 copë, me dimensione 4m x 4m =16m<sup>2</sup>, njëra anë e hapsirës.

## KRITERET E PËRGJITHSHME

1. Kriteri i dhënies së kontratës: Oferta më e favorshme ekonomike dhe me çmimin më të lartë;
2. Çmimi fillestar është **50 € (pesëdhjetë euro) për metër katror për një vit kalendarik;**
3. Afati i dhënies në shfrytëzim të hapësirave publike për reklamë është 2 vite nga dita e nënshkrimit të kontratës;
4. Veprimtaria që ushtrohet në hapësirat e dhëna në shfrytëzim është kryesisht veprimtari reklamuese biznesore, brenda hapësirave të përkufizuara sipas Drejtorisë për Shërbime Publike;

## INFORMATATA ADMINISTRATIVE

1. Afati i kohor i fundit për pranim-dorëzimin e Aplikacioneve: **data 04.01.2019 ora 12.00;**
2. Vendi i dorëzimit të ofertave të ankandit publik: Komuna Malishevës, Qendra për Shërbime të Qytetarëve –Shkresorja e Komunës;
3. Takimi për hapjen e Aplikacioneve është publik dhe do të bëhet më datë **04.01.2019, ora 14.00;**
4. Ofertat hapen publikisht në sallën e Kuvendit Komunal – Malishevë;
5. Ofertat duhen dorëzuar të mbyllura në zarf dhe të njëjtat të regjistrohen sipas procedurës së pranimi të shkresave;
6. Informacionet shtesë mundë t'i kërkonit përmes zyrtarëve të Drejtorisë për Shërbime Publike;
7. Ofertat e mbyllura ( dy kopje ) në formë fizike dorëzohen në Shkresoren e Komunës së Malishevës.

### Këshilla Juridike:

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë të Komisioni për Ankesa në Komunën e Malishevës, sipas dispozitave të nenit 9 pika 3 të Ligjit Nr. 04/L-144, Ligji për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunale.

Komisioni Komunal për Dhënie në Shfrytëzim të  
Pronës së Paluajtshme Komunale Malishevë

Kryesuesi i Komisionit

Bashkim Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr.02/ *244*

Datë: 02.07.2018

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2, shkronja (d), nenit 14 paragrafi 1, të Ligjit nr.03/040 për Vetëqeverisjen Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008), nenit 5 dhe 7 i Ligjit nr.04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.35/17, dhjetor 2012) nenin 4 dhe 5 të Rregullores QRK nr.23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, nenin 19 dhe 46 të Statutit të Komunës nr.01/871 të datës:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë: 29.06.2018 merr këtë:

V E N D I M  
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR

1. Miratohet kërkesa nr.01/525 e datës:12.04.2018 e parashtruar nga Kryetari i Komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër, të hapësirave publike për vendosjen e reklamave në qytezën e Malishevës.
2. Bazuar në pikën 1 të këtij vendimi hapësirat për vendosjen e reklamave do të jenë në sipërfaqe prej 288m<sup>2</sup>, në pjesët e ngastrave kadastrale në Zonën Kadastrale në Malishevë P.SH Rrugët si në vijim:  
Njësia kadastrale nr. P-72310047-00893-2 në pjesën e sipërfaqes nr.4469 m<sup>2</sup> ZK.Malishevë  
Njësia kadastrale nr. P-72310047-01423-0 në pjesën e sipërfaqes nr.36553 m<sup>2</sup> ZK. Malishevë  
Njësia kadastrale nr. P-72310047-01430-1 në pjesën e sipërfaqes nr. 28775 m<sup>2</sup> ZK. Malishevë  
Njësia kadastrale nr. P-72310047-01428-0 në pjesën e sipërfaqes nr.36880 m<sup>2</sup> ZK. Malishevë  
Njësia kadastrale nr. P-72310047-01427-3 në pjesën e sipërfaqes nr.23884 m<sup>2</sup> ZK. Malishevë
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës paluajtshme është krijimi i mundësive për të hyra publike në buxhetin e Komunës së Malishevës.
4. Afati kohor i dhënies së pronës së paluajtshme komunale, të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është afatshkurtër në periudhë kohore 2 (dy) vite, ndërsa çmimi bazë do të jetë 50€ (pesëdhjetë euro) për metër katror në vit, ndërsa në procedurë të ankandit do të përzgjidhet oferta ekonomiksht më e favorshme për Komunën.
5. Pronat e paluajtshme në fjalë nuk e ndërton titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Malishevës dhe si e tillë nuk mund t'i jepet në shfrytëzim personit të tretë nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër.
6. Obligohet komisioni për vlerësimin e ofertave që në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, dhe Rregulloren (QRK) nr.23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së



paluajtshme të Komunës, t'i zhvilloj procedurat e ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër.

7. Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni të përcaktoj me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.

8. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës përmes organeve kompetente.

9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:  
Arkivit të Komunës  
Drejtoreve të KK-së  
MAPL-së.

